

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

|         |                                                                                                                                                                                                                                       |
|---------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| TITULLI | Ministria e Drejtësisë - Gërvalla: Çështja e Speciales është betejë ligjore, jo betejë deklaratash                                                                                                                                    |
| ADRESA  | <a href="https://www.syri.net/kosova/919340/gervalla-ceshtja-e-speciales-eshte-beteje-ligjore-jo-beteje-deklaratash/">https://www.syri.net/kosova/919340/gervalla-ceshtja-e-speciales-eshte-beteje-ligjore-jo-beteje-deklaratash/</a> |
| BURIMI  | syri.net                                                                                                                                                                                                                              |
| GJENDJA | online                                                                                                                                                                                                                                |

## KOHA


|                       |                                                                                                                                                           |
|-----------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KAPUR NGA NE          | 26 shtator 2026, 15:25:14 UTC<br><i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>                            |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 26 shtator 2026, 14:14:29 UTC<br><i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i> |

## HASH-ET · SHA-256

|            |                                                                  |
|------------|------------------------------------------------------------------|
| PËRMBAJTJA | 795386cbe8eddb72d226645e4d51ae6e48429f9437c1ea63da8fdec74f30e497 |
| TEKSTI     | d6e368e6cabb36f76d5cbeecb22b50b4a7f138265af8682cad30f5f1d4c58dfc |
| PAMJA      | 60e0d80ac09b0d398ab4596e47823d24105ec08016ea91cf942f9922de3ccc51 |

## ZINXHIRI I PROVËS

|               |                                                                                                 |
|---------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KJO HYRJE     | 319710636ee4aa66b20e399770bd9277e25429f789351ebe2c43bb3bd3178c51                                |
| E MËPARSHMJA  | —                                                                                               |
| RRËNJA MERKLE | 0334a22cab892da6eda5613cc640e69aa8a23a21585bae5896651df887e79535                                |
| ANKORIMI      | submitted — dërguar, ende pa bllok<br><i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i> |



## SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/319710636ee4aa66b20e399770bd9277e25429f789351ebe2c43bb3bd3178c51>

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px





**SONILA MEÇO**  
'Në emër të popullit të Kosovës', prokura e një kurthi



**ÇIM PEKA**  
Nga Çim Peka-Tradhtia që s'e panë tu ardhë



## Gërvalla: Çështja e Speciales është betejë ligjore, jo betejë deklaratah

16:14, 26/09/2026

**Zëvendëskryeministria njëherësh ministria e Drejtësisë, Donika Gërvalla, ka thënë se çështja që lidhet me Dhomat e Specializuara duhet të trajtohet përmes punës ligjore dhe ekspertizës, duke deklaruar se Ministria e Drejtësisë po analizon edhe projektligjin e propozuar nga Partia Demokratike e Kosovës.**

Në një konferencë për media, Gërvalla tha se për çështjet që lidhen me Dhomat e Specializuara nevojitet kujdes dhe bashkërendim institucional.

"Shumica e gjërave që lidhen me Dhomat e Specializuara janë çështje të ekspertizës së lartë. Nevojitet kujdes i madh që të mos bëjmë gabime", tha Gërvalla.

Ajo theksoi se Ministria e Drejtësisë po e analizon projektligjin e propozuar nga PDK-ja dhe se, pas përfundimit të analizës, do t'ia përcjellë Qeverisë opinionin e saj.

"Nuk do ta vonojmë, shpejt do ta dërgojmë, por askush nuk duam të nxitohemi e ta paguajmë me cilësi të munguar e gabime të papranueshme", deklaroi ajo.

Gërvalla foli edhe për gjashtë projektligjet që, sipas saj, janë proceduar për në Kuvend, duke i cilësuar ato si pjesë të reformës së sistemit të drejtësisë.

Sipas ministres, njëra prej nismave është projektligji për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme. Ajo tha se projektligji është shqyrtuar në disa faza, përfshirë vlerësimin nga Komisioni i Venecias dhe shqyrtimin nga Gjykata Kushtetuese.

"Ky ligj nuk krijon një mekanizëm penal dhe Byroja nuk konfiskon pasuri. Projektligji parashikon një procedurë civile që zhvillohet para gjykatës", tha Gërvalla.

Ajo sqaroi se, sipas projektligjit, Byroja do të ketë rol përgatitor dhe analitik, ndërsa vendimin përfundimtar për konfiskimin e pasurisë do ta marrë gjykata.

Në konferencë, Gërvalla u pyet edhe për kritikën ndaj saj pas vendimit të Dhomave të Specializuara dhe kërkesat për dorëheqjen e saj.

Lidhur me pretendimet se ka bashkëpunuar me Dhomat e Specializuara, ajo tha se këto pretendime i ka mohuar edhe më herët.

## më të lexuarat

Në gjithë Kosovën sot protestohet kundër vendimit ndaj ish-krerëve të UÇK-së

Zuckerberg zbulon orën e tij: Zgjedhja e veçantë lidhet me orëndreqësin nga Kosova, Rexhep Rexhepi

Ambasada amerikane: Mezi presim të punojmë me Qeverinë dhe Kuvendin e ri të Kosovës

Gërvalla: Çështja e Speciales është betejë ligjore, jo betejë deklaratah

Vuçiçi akuzon Rashqin se me mbështetjen për Listën Studentore 'po zbaton urdhrat' e Kurtit

Nisma për ndryshimin e ligjit të Speciales është dërguar për mendim në Qeveri

Protestë para OKB-së në New York kundër vendimit ndaj ish-krerëve të

"Deklaratat që më lidhin mua në çfarëdo lloj forme me bashkëpunimin tashmë është bërë bajat, sepse i kam shpjeguar disa herë. Nuk ka në asnjë hallkë, as me EULEX-in, as me UNMIK-un, as me Gjykatën Speciale, nuk ka asnjë pikë takimi timin, as direkt dhe as indirekt", tha ajo.

Gërvalla tha se nuk e konsideron heshtje qëndrimin e saj pas aktgjykimit të Dhomave të Specializuara, duke theksuar se puna duhet të përqendrohet në aspektin ligjor.

"Unë nuk kam heshtur. Unë jam Ministre e Drejtësisë. Kryeministri ka dhënë një deklaratë në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, ndërsa unë së bashku me ekipin tim që nga dita e parë jam futur në punë me qëllim që të përgatitemi për një betejë, sepse çështja e Gjykatës Speciale është betejë ligjore, nuk është betejë deklaratash në media", deklaroi Gërvalla.

Ajo shtoi se, sipas saj, institucionet duhet të përgatiten për fazat e ardhshme të procesit.

"Duhet të jemi profesionistë, të mençur, me kokën të ftohtë, pa shumë bërtitje, duhet të përgatitemi për instancën e ardhshme", tha ministrja.

Sa u përket kërkesave për dorëheqjen e saj, Gërvalla tha se çdo qytetar ka të drejtë të kërkojë dorëheqjen e një zyrtari publik.

"Është e drejtë e secilit qytetar të Republikës së Kosovës të kërkojë dorëheqjen e secilit ministër. Ajo është, më në fund, jetojmë në një shtet demokratik ku është e drejtë e secilit të shprehë mendimin e tij", tha ajo.

Gërvalla theksoi se fokusi i saj mbetet puna në Ministrinë e Drejtësisë dhe zbatimin e reformave të propozuara në sistemin e drejtësisë.

Gërvalla për protestat: Janë protesta dinjitoze, qytetarët kanë të drejtë të protestojnë

E pyetur se cila është thirrja e saj për protestuesit në Prishtinë, Shkup dhe në qytetet e Evropës, si dhe nëse do t'u bashkohet protestave, Gërvalla tha se ajo e ndjen veçanërisht pozitën e familjarëve të viktimave.

"Unë kurrë nuk kam qenë, dhe sidomos kur nuk kam qenë anëtare e qeverisë, gjithmonë jam prononcuar dhe kam folur gjithmonë në anën e viktimave. Sepse mendoj që ka nevojë për zëra të fortë të cilët flasin për viktimat", tha Gërvalla.

Ajo tha se edhe gjatë kohës kur është pranë familjarëve të viktimave, qëndrimi i saj ka qenë në mbështetje të tyre.

"Edhe unë sa herë që qëndroj pranë familjarëve, fëmijëve të viktimave, qoftë të atyre të para luftës, gjatë luftës, apo edhe atyre të pas luftës, unë gjithmonë marr anën e viktimës", deklaroi ajo.

Gërvalla tha se Kosova është shtet demokratik dhe se qytetarët kanë të drejtë të protestojnë.

"Unë jam shumë e lumtur që ne jetojmë në një Kosovë të lirë, në një Kosovë të pavarur, në një Kosovë demokratike ku secili qytetar ka të drejtë të protestojë", tha ajo.

Duke folur për protestat e zhvilluara pas vendimit të Dhomave të Specializuara, Gërvalla i cilësoi ato si protesta dinjitoze.

"Shikojni protestat. Janë protesta dinjitoze, janë protesta të cilat barten nga qytetarët e Republikës, të cilët nuk lejojnë as të politizohen dhe as të provokohen", tha ajo.

E pyetur nëse do t'u bashkohet protestuesve, Gërvalla tha se ajo e sheh rolin e saj në kryerjen e detyrave institucionale.

"Unë mendoj që koha ime është shumë e rëndësishme të luaj rolin dhe të plotësoj detyrën time në këtë institucion, sesa të reklamoj vetveten nëpër protesta me qëllim që dikush që ndoshta mund të ketë një mendim specifik për mua ta ndryshojë mendimin", deklaroi ministrja.

"Unë jam shumë e bindur që këtu ku jam duhet t'i kryej punët e mia me qëllim që edhe të tjerët të mund t'i kryejnë punët e veta", përfundoi Gërvalla./ RTK.


© SYRI.net

Lexo edhe:



Rama zhgënjën mediat në Prishtinë: Kosova pa zë në OKB, asnjë fjalë për UÇK-në

UÇK-së



Mali i Zi ndalon ngarkesën me mish të skaduar të destinuar për Kosovën



Kurti: Zgjedhjet e reja janë të panevojshme e të kushtueshme



10 nete protesta kundër vendimit të ish-udhëheqesve të UÇK-së



Konjufca në New York: Aktgjykimi ndaj ish-krerëve të UÇK-së është padrejtësi që duhet të korrigjohet

## Komentet

Shto koment

Emri

Shkruani komentin tuaj

Posto

### TË NGJASHME



Kuvendi mban seancë të hënën, në rend dite Deklarata për aktgjykimin e Speciales



Deklarata kundër Speciales, Haxhiu: Do të kontribuojmë në draftimin e saj



Kurti: Zgjedhjet e reja janë të panevojshme e të kushtueshme



Mali i Zi ndalon ngarkesën me mish të skaduar të destinuar për Kosovën



Nisma për ndryshimin e ligjit të Speciales është dërguar për mendim në Qeveri



Vuçiçi akuzon Rashqin se me mbështetjen për Listën Studentore 'po zbaton urdhrat' e Kurtit

LAJME POLITIKË KRONIKË EKONOMI KOSOVA BOTË KULTURË SHKENCË SPORT JETË/STIL TRASHËGIMI MIEDIS ARKIVA



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do ti gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojme të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Stafi i SYRI.net

Për informacione [info@syri.net](mailto:info@syri.net), për reklama [marketing@syri.net](mailto:marketing@syri.net)

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.